



Njoftim për Media

Tiranë, më 31 Tetor 2024: Instituti i Statistikave (INSTAT) publikon sot rezultatet përfundimtare të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 në nivel Qarku dhe Bashkie, në përputhje me kalendarin zyrtar të publikimeve të institucionit.

Rezultatet e publikuara sot sjellin të dhëna më të detajuara mbi strukturën demografike dhe karakteristikat socio-ekonomike të vendit tonë, duke përfaqësuar një burim të vlefshëm informacioni për të gjithë shoqërinë. Linkun e publikimit e gjeni [këtu](#).

Institucionet publike dhe qeverisja vendore tashmë mund të kenë akses në një bazë të dhënash të saktë dhe të përditësuar, që do t'i ndihmojë ata në planifikimin e shërbimeve publike, menaxhimin e burimeve dhe zhvillimin urban në përputhje me nevojat e qytetarëve. Studiuesit dhe komuniteti akademik do të kenë mundësi të thellohen në analizat e zhvillimeve demografike, ndërsa bizneset dhe organizatat mund të përdorin këto të dhëna për vlerësime të tregut dhe projekte zhvillimore.

Gjatë këtij viti, INSTAT do të publikojë gjithashtu një databazë të përbashkët për censeve të viteve 2001, 2011 dhe 2023. Kjo platformë do t'i mundësojë të gjithëve të bëjnë krahasime ndër vite, duke siguruar një kuptim të thelluar të ndryshimeve demografike dhe sociale që kanë ndodhur gjatë këtyre dekadave.

Një aspekt kyç i këtij censi është krijimi i Regjistrit të Popullsisë dhe Regjistrit të Banesave. Këta regjistra do të jenë një instrument i rëndësishëm për sistemin statistikor të Shqipërisë, duke garantuar një pasqyrë të vazhdueshme dhe të saktë të popullsisë dhe banesave, dhe duke ndihmuar qeverisjen dhe sektorin publik në përmirësimin e politikave publike dhe optimizimin e shërbimeve vendore.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është përditësimi i gjeoportalit instatGIS, i cili do t'i ofrojë përdoruesve të dhëna të strukturuar dhe të gjeoreferuara, të lehta për t'u analizuar dhe përdorur për qëllime hulumtimi, planifikimi dhe vendimmarrje. Ky gjeoportali do të ofrojë një eksperiencë të avancuar për të gjithë ata që kanë nevojë për të dhënat statistikore të detajuara.

Ky publikim i INSTAT përfaqëson përpjekjet tona për të modernizuar shërbimet e INSTAT dhe për të sjellë statistikat më afër publikut dhe institucioneve, duke i bërë ato më të aksesueshme dhe të përdorshme për të gjithë.